



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 112, Datë 22.07.2019**

**MBI**

**MODIFIKIMIN E E LICENCËS SË SHOQËRISË “HENZ ENERGY” SH.P.K, NR. 158, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 65, DATË 28.05.2012, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET: “DARSI 1” ME KAPACITET 2240 KW, “DARSI 2” ME KAPACITET 7633 KW, “DARSI 3” ME KAPACITET 1066 KW, ME KAPACITET TOTAL 10939 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-S nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “HENZ ENERGY” shpk, për modifikimin e licencës së shoqërisë “HENZ ENERGY” shpk, nr. 158, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.05.2012, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “DARSI 1” me kapacitet të instaluar 2240 kW, “DARSI 2” me kapacitet të instaluar 7633 kW dhe “DARSI 3” me kapacitet të instaluar 1066 kW, me kapacitet total të instaluar 10939 kW,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-S me vendimin nr. 70, Datë 10.05.2019, ka filluar procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “HENZ ENERGY” sh.p.k, nr. 158, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.05.2012, “Për licencimin e shoqërisë “HENZ ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC – et “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”.

- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar, ERE me shkresën nr. 32/21 Prot., datë 10.05.2019, ka bërë publikimin në media lidhur me fillimin e procedurës për modifikimin e kësaj licence dhe mbas përfundimit të afatit, nuk ka patur komente apo objeksione nga palë të interesuara për ndryshimet e kërkuara nga subjekti për modifikimin e licences.
- ERE me shkresën nr. 287/1 Prot., datë 14.05.2019, ka njoftuar subjektin në lidhje me vendimmarrjen e Bordit.
- Modifikimi i licencës së sipërcituar, vjen si rezultat i optimizimit të skemës hidroenergjitike si dhe përmirësimit të të gjithë parametrave duke pakësuar numrin e HEC – eve nga 3 në 2, me ndërtimin e objektit konkret (Darsi 1 dhe Darsi 2) dhe rritjen e kapacitetit të instaluar respektivisht Darsi 1 me kapacitet të instaluar 3328kW dhe Darsi 2 me kapacitet të instaluar 11635kW.
- Shoqëria koncesionare “HENZ ENERGY” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të Kontratës Koncesionare, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Shqiponja-M” sh.p.k., “Iliriada” sh.p.k. dhe “Klenis” sh.p.k dhe Autoritetit Kontraktor me nr. 286 Rep dhe nr. 39 Kol, datë **30.01.2009**, “Për Ndërtim Operim Transferim e hidocentraleve, “Darasi 1”, me kapacitet 1500kW, “Darasi 2”, me kapacitet 2700, “Darasi 3” me kapacitet 2500 kW, “Darasi 4” me kapacitet 900 kW me kapacitet total **7600 kW**.
- Kjo kontratë është ndryshuar disa herë me kontrata shtesë, kryesisht për zgjatjen e afatit të vënies në shfrytëzim të HEC – eve me kontratat si më poshtë pasqyruar:
  - Kontratë shtesë nr. 2164 Rep dhe nr. 268 Kol, datë **20.08.2009** “Për ndryshimin e kontratës të formës “BOT”, për “Ndërtim Operim Transferim e hidocentraleve “Darsi 1”, me kapacitet 1974 kW, “Darsi 2”, me kapacitet 5844 kW, “Darsi 3” me kapacitet total jo me pak se **8902 kW**”;
  - Kontratë shtesë koncensionit të lidhur me palët METE dhe Shoqëria “Henz Energy” sh.p.k, nr. 42 Rep dhe nr. 13 Kol, datë **23.01.2013**, “Për një shtesë afati me 14 muaj për vënie në shfrytëzim të hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”;
  - Kontratë shtesë nr. 4678 Rep dhe nr. 1424/1 Kol, datë **06.08.2013**, “Për një shtesë afati me 16 muaj për vënie në shfrytëzim të hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”, “Për një shtesë afati me 61 muaj për vënie në shfrytëzim të hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3” “Darsi 4”, të kontratës bazë të koncensionit”;
  - Kontratë shtesë nr. 444 Rep dhe nr. 203/1 Kol, datë **06.08.2015**, të lidhur MEI dhe Shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k “Për një shtesë afati me 93 muaj, jo për shkak të sajë, për vnie në shfrytëzim të hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3” “Darsi 4”, të kontratës bazë të koncensionit nr. 286 Rep dhe nr. 39 Kol, datë 30.01.2009;
  - Kontratë shtesë nr. 711 Rep dhe nr. 302 Kol, datë **25.05.2017**, “Për një shtesë afati në vijim të afatit të më parshëm me 24 muaj për vnie në shfrytëzim të hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”.

- Së fundmi është ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit me nr. 2105 Rep dhe nr. 1120/3 Kol, datë **28.09.2018**, të lidhur ndërmjet MIE dhe Shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k, “Për një ndryshimin e kontratës të formës “BOT”, për “Ndërtim Operim Transferim e hidocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3” “Darsi 4”, e ndryshuar”. Kjo shtesë kontrate vjen si rezultat i ndryshimit të projektit teknik dhe bën të domosdoshëm modifikimin e licencës, e cila lidhet me faktin e ndryshimeve të skemës së dalë gjatë zbatimit të punimeve që bëri të mundur rritjen e parametrave të kapacitetit të instaluar dhe reduktimin e numrit të hidrocentraleve.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.05.2012, shoqëria “Henz Energy” sh.p.k është licencuar për fuqitë përkatëse si më poshtë:
 

- HEC “Darsi 1”	kapaciteti i instaluar	2240kW
- HEC “Darsi 2”	kapaciteti i instaluar	7633kW
- HEC “Darsi 3”	kapaciteti i instaluar	1066kW
- Gjithsej kapacitet i instaluar		<b>10939kW</b>
- Nga kontrata shtesë e koncesionit nr. 2105 Rep dhe nr. 1120/3 Kol, datë 28.09.2018, rezulton se kapaciteti i HEC-eve, është si më poshtë dhe është reduktuar numri i HEC-eve nga 3(tre) në 2(dy) dhe me fuqitë përkatëse si vijon:
 

- HEC “Darsi 1”	kapaciteti i instaluar	3328kW
- HEC “Darsi 2”	kapaciteti i instaluar	11635kW
- Gjithsej kapacitet i instaluar		<b>14963kW</b>
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Henz Energy ” sh.p.k, në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, rezulton si më poshtë:
  - Neni 9, pika 1, germat a). b), c) plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Neni 15, pika 4, germat a). b), c), d), e) plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HENZ ENERGY” sh.p.k, për modifikimin e licencës nr. 158, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.05.2012, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “DARSI 1” me kapacitet të instaluar 2240 kW, “DARSI 2” me kapacitet të instaluar 7633 kW dhe “DARSI 3” me kapacitet të instaluar 1066 kW, me kapacitet total të instaluar 10939 Kw.
2. Në përmbajtjen e licencës nr. 158, Seria PV12K, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 2105 Rep dhe nr. 1120/3 Kol,

datë 28.09.2018, “Për ndryshimin e kontratës të formës “BOT”, për “Ndertim Operim Transferim e hidocentraleve :“Darasi 1”, “Darasi 2” dhe “Darasi 3” , si më poshtë:

Ishte: “DARSI 1” me kapacitet të instaluar 2240 kW;

“DARSI 2”, me kapacitet të instaluar 7633 kW dhe

“DARSI 3” me kapacitet të instaluar 1066 kW,

me kapacitet total të instaluar 10939 kW.

Bëhet: HEC “DARSI 1” kapaciteti i instaluar	3328kW
HEC “DARSI 2” kapaciteti i instaluar	11635kW
Kapaciteti Total i instaluar	14963kW

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**PETRIT AHMETI**